

VENDIM

Kolegji Administrative i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej :

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar

Në datën 12.12.2017 mori në shqyrtim në seance gjyqësore çështjen që ju përket palëve:

PADITËS: SPARTAK BUNDO

PADITUR: DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS
KOMBËTARE KORÇË

OBJEKTI:

Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me 12 paga për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.
Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e një muaji për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës
Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e dy muaj pagë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Baza Ligjore: Neni 32/a të K.Pr.Civile, nenet 143, 144, 152, 153, 155 të K.Punës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 2506 (41-2013-4892), datë 16.12.2013 ka vendosur:

1. Deklarimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për gjykimin e çështjes civile me nr. regj. them. 12003 - 02965 - 41 - 2013 (2612), që i përket:

Paditës: Spartak Bundo

I paditur : Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë

Objekti: Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me 12 paga për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimi i palës së paditur të më shpërblejë me dy pagë për mosrespektim të afatit një mujor të njoftimit dhe dy muaj pagë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

2. Dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 21, datë 04.02.2014 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë ti paguajë paditësit Spartak Bundo:

- 1 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës në shumën 35.000 lekë.
- 2 muaj pagë si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës në shumën 70.000 lekë
- 6 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi në shumën 210.000 lekë.
- Gjithësej 315.000 lekë

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1510, datë 07.05.2014 ka vendosur:
Ndryshimin e Vendimit nr. 21, datë 04.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
Rrëzimin e padisë.

V E N D O S I:

Prishjen e vendimit nr. 1510 datë 07.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 21 datë 04.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Tiranë, më 12.12.2017

**Nr. 31003-04081-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr.00-2017- 2422 i Vendimit (879)**